



Njoftim

“Për procedurën e uljes së tarifës vjetore të shkollimit të studentëve të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2018-2019”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, njoftojmë studentët që studiojnë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në ciklin e dytë, dhe që i përkasin kategorive të mëposhtme:

1. Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
2. Studentët familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;
3. Studentët që kanë përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
4. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;
5. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfutur statusin ligjor për trajtim si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore;
6. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;
7. Studentët romë dhe ballkano – egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale dhe/ose deklaratë noteriale.
8. Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

se formulari i aplikimit “PRAKTIKË PËR ULJEN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT” gjendet në web – site: www.uniel.edu.al rubrika Informacione / njoftime dhe të shkarkohet nga kjo adresë.

Dokumentacioni i përgatitur sipas formularit përkatës të dorëzohet nga vetë studenti në Rektorat deri më datë **18.01.2019**.